



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Kuvendi i Komunës

Nr. 02/ 368

Datë: 12.08.2022

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), neni 40 paragrafi 2 pika (e), të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr.28/15 qershor 2008", neni 5 paragrafi 5.2 të Ligjit Nr.03/L-087 për ndërmarrjet publike "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.31/15 qershor 2008, Ligjit Nr.04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe në pajtim me nenin 10 dhe 19 të Statutit të Komunës së Malishevës Nr.01/871 datë: 12.11.2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e mbajtur me datë: 09.08.2022 merr këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE PËR NDËRMARRJEN
PUBLIKE "EKO-REGJIONI" SH.A PRIZREN, NJËSIA NË MALISHEVË

1. Formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike "Eko-Regjioni" Sh.A. Prizren, Njësia në Malishevë.
2. Mbështetur në pikën 1 të këtij vendimi Komisioni në përbërje prej tre (3) anëtarëve do të jetë si në vijim.
 - 2.1. Valon Mazreku - anëtar i Kuvendit
 - 2.2. Hamit Lima - anëtar i Kuvendit
 - 2.3. Valmir Gashi - anëtar nga zyra e Kryetarit të Komunës.
3. Komisionit do të veprojë në emër të Komunës së Malishevës dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe Ligji për Shoqëritë Tregtare.
4. Komisioni Komunal i Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike "Eko-Regjioni" Sh.A. Prizren, Njësia në Malishevë, si në pikën 1 të këtij vendimi i përgjigjet Kuvendit Komunal mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat u janë dhënë me ligj, Komisioni po ashtu do t'i raportojë Kuvendit Komunal në bazë vjetore.
5. Mandati i anëtarëve zgjatë aq sa zgjatë mandati i rregullt i anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Malishevës.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, përmes Kuvendit.
7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008", neni 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr.10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr.06/2021 dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet
Arkivit të Komunës
MAPL-së
Drejtorive të KK-së.

